



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 21 gusht 2024

Njoftim për shtyp

Zhvillimet monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: korrik, 2024

- Në korrik 2024, **paraja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})** shënoi rritje mujore prej 0,5%, kryesisht si rezultat i rritjes së parave të gatshme në qarkullim, me rritje shtesë të depozitave afatgjata dhe të parave të depozituara dhe depozitave afatgjata deri në dy vjet. Në bazë vjetore, paraja e gjerë është rritur për 5,6%, kryesisht për shkak të rritjes së parave të depozituara, me kontribut pozitiv edhe të depozitave afatgjata deri në dy vjet dhe parave të gatshme në qarkullim, ndërsa depozitat afatshkurtëra shënuan rënie.
- Totali i depozitave³**, në korrik, shënoi rritje prej 0,5% në bazë mujore, me rritje vjetore prej 7,3%. Njëkohësisht, ndryshimi mujor dhe ai vjetor, kryesisht vjen nga rritja e depozitave në sektorin "amvisëritë", me rritje më të lehtë edhe të depozitave të sektorit korporativ.

Tabela 1. Paraja e gjerë dhe totali i depozitave të sektorit joqeveritar

	gjendja (në milionë denarë)				ndryshimet vjetore (so %)				ndryshimet mujore (në %)			
	12.2023	3.2024	6.2024	7.2024	12.2023	3.2024	6.2024	7.2024	12.2023	3.2024	6.2024	7.2024
Paraja e gjerë M4	595,151	591,336	607,881	611,809	8.7	9.5	7.6	7.6	4.3	-0.7	0.5	0.6
Paraja e gjerë M3	529,264	521,804	535,985	538,400	5.9	6.6	5.4	5.6	4.5	-0.9	0.4	0.5
<i>nga të cilat:</i>												
<i>Paratë në qarkullim</i>	50,002	49,336	51,377	52,759	5.3	8.6	7.6	8.4	7.5	1.5	2.2	2.7
<i>Depozitat e parave</i>	211,402	202,074	211,126	211,783	12.4	11.4	8.8	9.4	10.0	-1.9	0.3	0.3
<i>Depozitat afatshkurta</i>	215,860	215,551	215,501	215,451	0.6	1.0	0.1	-0.5	-0.5	-1.1	0.2	0.0
<i>Depozitat afatshkurta deri në 2 vjet</i>	51,999	54,842	57,981	58,406	4.5	10.8	12.7	14.8	2.1	1.4	0.0	0.7
Totali i depozitave	534,241	531,140	544,683	547,210	8.7	9.3	7.2	7.3	4.0	-0.9	0.4	0.5
<i>nga të cilat:</i>												
<i>Sektori korporativ</i>	161,432	150,674	153,830	154,171	13.2	12.2	4.7	3.9	6.6	-2.4	1.0	0.2
<i>Në denarë</i>	109,266	100,009	103,684	103,028	15.8	12.5	5.6	3.9	8.5	-3.6	1.7	-0.6
<i>Në valutë të huaj</i>	52,166	50,664	50,146	51,143	8.2	11.4	2.8	3.9	2.7	0.1	-0.4	2.0
<i>Amvisëritë</i>	348,745	354,741	364,432	367,103	7.9	8.7	8.9	9.6	3.5	0.1	0.0	0.7
<i>Në denarë</i>	173,543	177,631	184,627	187,014	11.8	13.7	13.1	14.5	6.4	0.6	-0.6	1.3
<i>Në valutë të huaj</i>	175,201	177,109	179,805	180,088	4.4	4.0	4.8	4.9	0.7	-0.3	0.5	0.2

Burimi: BPRMV-ja.

¹Duke filluar nga qershori 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si përkufizim i ri standard për paranë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetar M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

²Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: <https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20 monetarna 07 2021 al.pdf>

³Totalin e depozitave e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetare M4, të cilat i takojnë sektorit korporativ, amvisërive, institucioneve tjera financiare, institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive dhe vetëqevirsjes lokale.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në korrik, **totali kredive**, shënoi rritje për 0,6% dhe përkatësisht 7,3%, në bazë mujore dhe vjetore. Ndryshimi mujor dhe vjetor është rezultat i rritjes së kerditimit në dy sektorët, me kontribut më të shprehur në rritjen e kredive të sektorit "amvisëri".


Tabela 2. Totali i kredive në sektorin joqeveritar

	gjendja (në milionë denarë)				ndryshimet vjetore (so %)				ndryshimet mujore (në %)			
	12.2023	3.2024	6.2024	7.2024	12.2023	3.2024	6.2024	7.2024	12.2023	3.2024	6.2024	7.2024
Totali i kredive	444,721	449,251	462,435	465,244	5.1	6.1	6.4	7.3	1.3	0.3	0.8	0.6
<i>nga të cilat:</i>												
Sektori korporativ	212,768	214,268	221,765	222,904	3.3	5.4	5.8	7.3	2.2	0.0	0.6	0.5
Në denarë	131,089	134,280	144,110	146,001	7.1	11.9	16.2	18.4	2.7	1.0	2.6	1.3
Në valutë të huaj	81,679	79,988	77,656	76,902	-2.3	-3.9	-9.3	-9.1	1.4	-1.7	-2.8	-1.0
Amvisëritë	229,404	232,313	238,057	239,937	6.7	6.8	7.1	7.5	0.5	0.5	1.0	0.8
Në denarë	125,223	126,809	130,453	131,765	5.1	5.8	7.2	7.7	0.0	0.3	1.2	1.0
Në valutë të huaj	104,180	105,504	107,603	108,171	8.8	8.1	7.0	7.2	1.2	0.6	0.7	0.5


Burimi: BPRMV-ja.



Burimi: BPRMV-ja.



1. Depozitat dhe kreditë e sektorit korporativ⁴





Burimi: BPRMV-ja.

⁴ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin kompanitë publike dhe private jofinanciare.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në korrik, totali i **depozitave të sektorit korporativ** shënoi rritje prej 0,2% në bazë mujore. Analizuar sipas valutave, rritja tërësisht rrjedh nga rritja e depozitave afatshkurtëra në valutë të huaj, derisa komponentet tjera shënojnë rënie. Rritja vjetore arrin 3,9% dhe vjen si pasojë e rritjes së parave të depozituara dhe rritjes së depozitave afatshkurtëra në valutë të huaj dhe në denarë, ndërsa depozitat afatshkurtëra në valutë të huaj dhe në denarë janë ulur.
- Këtë muaj, **kreditë e sektorit korporativ**⁵, shënuan rritje mujore prej 0,5%, me rritje vjetore prej 7,3%. Rritja në të dyja bazat është në tërësi si pasojë e rritjes së kreditimit në denarë, ndërsa kreditimi në valutë të huaj është ulur.



Burimi: BPRMV-ja.

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive⁶



Burimi: BPRMV-ja.



⁵Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.

⁶Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe të ekzekutuesve të pavarur të veprimtarisë.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Totali i depozitave të amvisërive**, këtë muaj, shënoi rritje mujore prej 0,7%, shkaku i rritjes së depozitave afatgjata në denarë dhe në valutë të huaj, si dhe parave të depozituara, në kushte të rënies së depozitave afatshkurtëra në valutë të huaj dhe në denarë. Në bazë vjetore, totali i depozitave të amvisërive është më i lartë për 9,6%, si rezultat i rritjes së parave të depozituara dhe depozitave afatgjata në denarë dhe në valutë të huaj, me rënie të depozitave afatshkurtëra në valutë të huaj dhe në denarë.
- Në korrik, te **kreditë e amvisërive**, është realizuar rritje mujore dhe vjetore prej 0,8% dhe 7,5%, përkatësisht, si rezultat i rritjes së kreditimit në denarë dhe në valutë të huaj, me kontribut më të shprehur te kreditë në denarë.



Burimi: BPRMV-ja.



Burimi: BPRMV-ja.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Tabela 2. Kreditë e bankave dhe kursimoreve të dhëna për personat fizikë, sipas qëllimit

	gjendja (në milionë denarë)				ndryshimet vjetore (në %)				ndryshimet mujore (në %)			
	12.2023	3.2024	6.2024	7.2024	12.2023	3.2024	6.2024	7.2024	12.2023	3.2024	6.2024	7.2024
Kreditë konsumatore	119,868	119,858	122,818	123,964	6.5	5.8	5.8	6.3	1.1	0.4	0.8	0.9
Kreditë për banesa	83,891	85,555	87,920	88,583	10.5	10.4	10.2	10.5	1.4	1.0	0.9	0.8
Kreditë për automjete	399	399	458	469	11.4	13.1	25.3	23.6	2.7	1.8	7.5	2.5
Kartat e kreditit	9,835	9,459	9,332	9,313	-4.7	-6.8	-8.0	-8.0	-1.9	-0.8	-0.3	-0.2
Bilancet negative të llogarive rrjedhëse	6,000	6,820	6,846	6,777	0.6	6.1	7.9	8.4	-13.8	2.3	5.7	-1.0
Kreditë e miratuara mbi baza të tjera	1,782	1,658	1,579	1,579	-19.3	-21.2	-18.8	-18.4	-2.5	-1.7	-2.0	0.0

Burimi: BPRMV-ja.

- Në korrik të vitit 2024, analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizikë, te **kreditë konsumatore dhe banesore**, si kategori më të përfaqësuar, shënohet rritje mujore prej 0,9% dhe 0,8%, përkatësisht, me një rritje vjetore prej 6,3% dhe 10,5%, përkatësisht. **Kreditë për automjete**, këtë muaj, shënojnë rritje për 2,5% dhe 23,6% në bazë mujore dhe vjetore, përkatësisht, ndërsa kreditë e miratuara për **kartelat kreditore** shënojnë rënie për 0,2% dhe 8,0%, në bazë mujore dhe vjetore, përkatësisht. Në korrik, **bilancet negative të llogarive rrjedhëse** shënojnë rënie mujore prej 1,0%, gjatë rritjes vjetore prej 8,4%. Kreditë e miratuara në baza tjera, në korrik, në bazë mujore mbesin të pandryshuara, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë ulur për 18,4%.

Informacione shoqëruese

Seri kohore të të dhënave: Balance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore https://www.nbrm.mk/monetarna_statistika-al.nspj

Shpjegime metodologjike:

[Metodologjia monetarna 07 2021 al.pdf](https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf) (nbrm.mk)

Informacioni për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesi:

https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 20 shtator 2024 (mesatare referuese, përfshirë gushtin e vitit 2024).

Për pyetje të gazetarësh, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokal 02/3215-235). 108/110.